



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 19.06.2026

PROCESVERBAL

**Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë
arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë për
Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029
I mbajtur më 11.06.2026 (e enjte)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash**

Dëgjimi buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2027-2029 është mbajtur sipas Kalendarit të dëgjimeve buxhetore, të publikuar në uebfaqen zyrtare dhe Facebook më datën **26.05.2026**.

Kalendari i publikuar në uebfaqen zyrtare:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Kalendari-i-protokolluar.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/05/Kalendar-i-protokolluar.pdf>

Kalendari i publikuar në Facebook-un zyrtar:

Shqip:

https://www.facebook.com/permalink.php?story_fbid=psfbid02yrHsDF9BngXR2Y3CSbvFy8XhXVzvwBQQCjWgiNGCZE6y3z6mwWzb1HMjRZYE6DAcFl&id=100066575766996

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1bPYBF9PLU/>

Njoftimi në uebfaqen zyrtare: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftimi-ne-uebfaqe-Degjimi-2-i-protokolluar.pdf>

Dëgjimi buxhetor ka filluar në **ora 11:00** dhe ka përfunduar në **ora 12:00**.

Në këtë Dëgjim buxhetor kanë qenë prezentë **15 pjesëmarrës, prej tyre 15 meshkuj dhe 0 femra**.

Hapjen e takimit e ka bërë drejtori për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim, i cili fillimisht ka përshëndetur të pranishmit.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Më lejoni që ta filloj diskutimin dhe t'ju njoftoj se këtu me mua prezent është edhe zyrtari i Zyrës për Komunitete, shefi Uzair Hamza. KAB-i është një dokument ligjor të cilin e përgatit Komuna, pasi e merr Qarkoren Buxhetore nga Ministria. Me Qarkore Buxhetore nënkuptojmë limitet të cilat i përshkruan Qeveria për ndarjet buxhetore u lëshohen komunave. Me fjalën kornizë nënkuptojmë limitet të cilat mund të shkojmë në maksimum dhe në minimum, dhe që nuk mund t'i tejkalojmë. Si të gjitha vitet tjera, edhe këtë vit buxheti i Qeverisë ndahet në Grantin e Përgjithshëm, Grantin Specifik të Arsimit dhe Grantin Specifik të Shëndetësisë. Sot ju kemi futar juve që të jeni bashkëpjesëmarrës në hartimin e buxhetin e vitit 2027 dhe për projeksionet e viteve 2028-2029, në lëmin e arsimit dhe të shëndetësisë. Prandaj, paraprkisht po ju njoftoj me buxhetin të cilin e kemi për detyrë ta shpërndajmë. Për vitin 2027 janë paraparë: Granti i Përgjithshëm është në vlerë **8,689,000** euro; Granti Specifik i Arsimit është **2,983,000** euro; dhe Granti Specifik i Shëndetësisë është **1,778,000** euro. Të hyrat vetanake janë planifikuar për vitin 2027 në vlerën **591,000** euro. Pra, totali i buxhetit për vitin 2027 është **14,043,000** euro. Këtë buxhet e kemi shpërndarë në kategori buxhetore: për Paga dhe Mëditje kemi **7,330,128** euro; për Mallra dhe Shërbime **2,013,000** euro; për Shpenzime Komonale **400,000** euro; kemi një rritje të Subvencioneve për vitin 2027, në vlerë prej **591,000** euro; ndërsa tek Investimet Kapitale kemi **3,808,000** euro. Komplet buxheti, siç thamë, është **14,043,370 euro**. Buxheti ndahet në bazë të numrit të popullsisë, shtrirjes gjeografike dhe etniteteve. Ka disa kritere të vogla, sipas numrit të nxënësve, sipas numrit të infermierëve dhe të mjekëve për kokë banori. Në përgjithësi, për shkak të regjistrimit të popullsisë – ju e dini që kemi pas rënie të numrit të banorëve – për fat të keq tonin, sivjet kemi 800 mijë euro buxhet më të ulët në raport me vitet paraprake. Edhe pse në kumulativ tregon se kemi një rritje, në raport me ndarjen për kokë banori, kemi një ulje prej 800 mijë euro. Këto na kanë reflektuar shumë në arsim, edhe pse ne me ndarje buxhetore jemi munduar ta kompenzojmë këtë problem. Prandaj, mendoj se edhe për vitin 2027 do të kemi një komoditet buxhetor, por jo edhe ashtu qysh e kemi prit. Fillimisht po ia kaloj fjalën shefit të Zyrës për Komunitete, z.Uzair Hamza, që ta prezantoj ndarjen buxhetore proporcionale sa i përket komuniteteve joshumicë, dhe pastaj do ta hapim debatin, në mënyrë që edhe ju t'i jepni propozimet tuaj, idetë dhe projektet konkrete të cilat dëshironi që t'i inkorporoni në këtë kornizë buxhetore.

Uzair Hamza, shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim: Sot buxheti në fakt është një debat që ka të bëjë me arsimin dhe shëndetësinë. Dëshiroj të theksoj dhe të shfrytëzoj rastin për ta informuar opinionin publik se është me rëndësi që investimet kapitale të parapara për vitin 2027, në vlerë prej 3.790.000 eurosh, janë ndarë në përputhje me përqindjen e komuniteteve joshumicë që jetojnë në Komunën e Dragashit.

Në regjistrimin e fundit të popullsisë të vitit 2024, siç ju është e njohur, 40% e popullsisë rezidente jeton në zonën e Gorës në Komunën e Dragashit. Në bazë të kësaj është bërë edhe ndarja e buxhetit, kështu që në fshatrat e Gorës do të investohen 1.376.000 euro nga buxheti i dedikuar për investime kapitale.

Pra, nga 3.790.000 euro, 1.376.000 euro do të investohen në fshatrat e Gorës. Zyra për Komunitete, së bashku me bashkëpunëtorët e saj, duke përfshirë edhe personat që janë të përfshirë drejtpërdrejt në përgatitjen e buxhetit, ka bërë një planifikim paraprak në bazë të kërkesave të përfaqësuesve të fshatrave, lidhur me atë se në cilat fshatra dhe në çfarë mase do të investohen këto mjete. Por ajo që është më e rëndësishme, dua të theksoj se buxheti është ndarë në përputhje me përqindjen. Në Dragash, nga mjetet e përbashkëta, 350.000 euro do të investohen nga buxheti për investime kapitale, i cili është i dedikuar si për komunitetin shumicë ashtu edhe për komunitetet joshumicë. Pra, Dragashi si qendër komunale do të përfitojë mjete financiare nga buxheti i përbashkët.

Sa i përket investimeve në fshatrat e Gorës, në sektorin e shëndetësisë do të investohen 80.000 euro, përkatësisht këto mjete do të shpenzohen për renovimin e ambulancave, ndërsa në arsim do të investohen 50.000 euro. Pra, gjithsej 130.000 euro nga buxheti i përgjithshëm prej 1.376.000 eurosh do të ndahen për këto dy kategori që i përmenda, dhe të cilat kanë të bëjnë ekskluzivisht me renovimin e ambulancave dhe shkollave.

Kjo është ajo që unë, si shef i Zyrës për Komunitete, e kam për obligim ta them dhe ta informoj opinionin publik, pra se Zyra e përcjell rregullisht situatën dhe, në bashkëpunim me kryetarin e komunës, përpiqet të respektojë përqindjen e mjeteve të dedikuara për komunitetet joshumicë.

Faleminderit.

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Faleminderit! Atëherë, fillimisht po fillojmë ta lexojmë Listën e investimeve kapitale të parapara.

Ne u munduam sa më shkurtë që t'ju japim informacione, të jeni të informuar me buxhetin, që të mund të parashtroni pyetje dhe kërkesa. Sa u përket edhe projekteve të tjera, të cilat nuk i kemi bërë publike, janë projekte të cilat mbulohen nga Mallrat dhe Shërbimet. Ju e dini se shpenzimet e energjisë i kemi marrë të gjitha përsipër, por nuk e di sa është me rëndësi me jua marrë kohën dhe me i përmend.

Ne tash e bëjmë transportin e nxënësve; participimin në shëndetësi e kemi heq krejt, e bëjmë furnizimin me barna esenciale; të gjitha bizneset janë të liruara prej taksës nga veprimtaritë, nuk e kemi qit taksën e akomodimit, dhe të gjitha burimet e vetme financiare nga të hyrat vetanake i kemi kryesisht nga tatimi në pronë. Pra, çdo qytetar i Komunës së Dragashit është i barabartë. Njëkohësisht, për vitin 2027 kemi paraparë 600 mijë euro subvencione për OJQ-të – është hera e parë – ku janë përfshirë edhe studentët të cilët studiojnë jashtë vendit.

Pas këtij prezantimi, ju ftoj që ta jepni kontributin tuaj, të parashtroni pyetje ose të jepni ndonjë sugjerim, ose të na propozoni ndonjë projekt që të jetë pjesë e buxhetit.

Behar Shala, drejtor i ShFMU “Shaban Shabani” – Llopushnik: Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket investimeve kapitale afatmesme buxhetore, për vitin 2026-2028 e kam fjalën, pata bërë një kërkesë, që e vetmja shkollë prej pasluftës deri më tani që jam në këtë foltore, nuk ka sallë të Edukatës Fizike, të paktën nuk ka as fushë të Edukatës Fizike. Kërkesa ime ka qenë edhe një vit më herët, mirëpo tash në planifikim prapë nuk e përmendet. Ndoshta e keni lënë për ndonjë planifikim tjetër. Tjetër, përveç kanalizimit që e përmendet, në projekt është mirë me e fut edhe rrjetin e ujësjellësit, sepse shkolla e re e ka ujin me pus. Me e marrë prej QMF-së, deri të shkolla me e pru ujin me rënie të lirë. Një udhë e dy punë, me e shfrytëzue rastin. Investimet e tjera kapitale i keni të dërguar në protokollin e DKA-së. Faleminderit!

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Faleminderit! Janë dy kërkesa inovative. Ne do të mundohemi që ta shqyrtojmë, sepse e dini që kemi pas investime më primare të ujit dhe të impiantit, që na kanë kushtuar, dhe nuk kemi mund me e bart, se një sallë e tillë është pak më e kushtueshme. Në qoftë se mund të gjejmë donatorë, tash te shkolla e vjetër mund ta shfrytëzojmë dhe ta ndërtojmë, kemi hapësirë edhe mundësitë janë shumë të mira. Këtë e dimë, por për shkak të buxhetit jemi këtu ku jemi. Megjithatë, nuk e kemi pas mendsh. Në qoftë se do të gjejmë donatorë, gjithsesi i hyjmë edhe kësaj pune. Për të mos e gënijer opinionin, me investime vetanake kapitale, e kemi vështirë një sallë të tillë me e rregullue. Sa i përket çështjes së ujit, unë mendoj se këtë mund ta kryejmë edhe me Mallra dhe Shërbime. Mendoj se kemi mundësi, vetëm i evidentoni, sot i fusim edhe në procesverbal. Nëse mund ta planifikojmë me Mallra dhe Shërbime, mund ta kryejmë, sepse besoj që nuk është ndonjë investim i madh. Kemi edhe mjete të lira për investime kapitale në DKA. Meqenëse i përket shkollës, mundemi edhe prej aty me e planifikue.

Beqir Beqaj, drejtor i Radio Sharrit: Përshëndetje për të gjithë! Pak më parë ishte këtu edhe drejtori i Shkollës “Sezai Surroi” në Bellobrad, tani nuk po e shoh. Prandaj, dola këtu që, të konsultoheni me të dhe t’i verifikoni këto që po ju them, se shkolla ka nevojë për ndërhyrje. Është e dëmtuar shumë sa i përket fasadës jashtë. Shkolla, prej se është ndërtuar, ende nuk ka rrufepritës të instaluar. Pra, duhet

të ndërhyhet edhe në këtë aspekt. Për detaje, do të merrni më shumë informata nga drejtori i kësaj shkolle. Meqë jemi te arsimit, te shëndetësia, sa i përket QMF-së pikërisht në Bellobrad, është një objekt shumë i mirë, por është shumë i fshehtë. Prandaj, do të ishte mirë, me pak investim, një sinjalistikë në rrugën kryesore ta kishte, që secili ta kuptojë se në atë rrugicë ndodhet edhe QMF-ja, e pse jo të mos ketë edhe shërbimet që i kryen aty, sepse ende shumëkush nuk e di se edhe me analiza merret ajo qendër. Dhe, prapë që ndërlidhet me shëndetin, ju e dini, drejtor, se përherë ka kërkesa që të funksionalizohet ajo udha e vjetër në Bellobrad, për arsye se aty tashmë kemi dukuri shumë negative, por edhe të shëmtuara, pikërisht për shkak se nuk është e qarkullueshme. Aty hidhen mbeturina, aty hidhen edhe kafshë të ngordhura, aty qarkullojnë automjete të dyshimta që Zoti e di se çfarë ndodh në atë udhë. Prandaj, do të ishte mirë – ju e dini se nuk do edhe shumë financim tashmë, sepse edhe projekti kur ka kaluar nga traseja e re, ka qenë qëllimi t'i ikte asaj kthesës. Te ajo kthesa mund një stadium të ndërtohet aty, se jo më që paraqet rrezik, falë inxhinierëve zviceranë që e patën siguruar poshtë, bazën. Nëse ndërhyhet tek ajo udhë, pikërisht ajo kthesa që dikur paraqiste rrezik, unë propozoj të jetë një panoramë – sepse ka vend ku mund të parkohen automjetet dhe të ndalojë dikush për qefin e tij, ta ketë një panoramë dhe fshati të duket sikur në shuplakë të dorës. Amfiteatrin e keni bërë të shkëlqyeshëm, tashmë është bërë edhe si ikonë e Bellobradit. Aty është edhe xhamia e re që prapë ia ka shtuar pamjen. Kemi informacione se do të ketë edhe ndërhyrje të tjera tek ai shesh, të bëhet një vend shumë i mirë. Por, ajo që e shëmtton është ajo pjesa ku dikur i gjithë fshati hidhnin mbeturina, sot hedhin mbeturina vetëm ata që nuk paguajnë. Dhe, do të ishte mirë që aty të ndërtohej një trotuar, dhe menjëherë pas trotuarit, një rrethojë, në mënyrë që të parandalohet hedhja e mbeturinave aty. Faleminderit shumë!

Qamil Kolloni – drejtor për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim: Faleminderit! Ne këto po i marrim si të mirëqena. Këto janë kërkesa shumë reale, është desht me ardhë prej Kryesisë së fshatit. Këto projektet tua janë edhe në të mirë të ambientit dhe turizmit. Më duket se gradualisht do të vijë në rend, dhe ajo do të bëhet si domosdoshmëri, si një rrugë qarkore. Por, me këtë buxhet nuk i kemi planifikuar, unë mendoj se këto si kërkesa do të evidentohen, dhe do ta diskutojmë edhe në Kuvend. Nëse mundemi që diku, prej 30 mijë eurove sa kemi të parapara në Bellobrad për kubëzim, bile së paku një pjesë me mund me e shfrytëzue edhe nga kjo rruga, se nuk besoj se kushton aq. Mirëpo, edhe te Mejdani, ajo duhet të asfaltohet, duhet të rregullohet, edhe të bëhet një shetitore bukur e mirë. Por, pasi që nuk e kemi të planifikuar, nuk mund të ju them asgjë me siguri. Të gjitha kërkesat janë të arsyeshme, çështja është te koha dhe paratë se kur mundemi me arrit me i realizue. A ka dikush tjetër që do me e marrë fjalën? Nëse nuk ka, ju falënderojmë shumë për pjesëmarrje! Shihemi në takimet e radhës!

Uzair Hamza, shef i Zyrës për Komunitete dhe Kthim: Dua vetëm të shpreh keqardhjen që nuk kishte më shumë përfaqësues të bashkësive lokale dhe kjo është diçka jo e mirë. Dëshiroj që ata të marrin pjesë në diskutimet për buxhetin, të japin propozimet e tyre, si edhe përfaqësuesit e institucioneve shëndetësore, veçanërisht drejtorët e shkollave, sepse është e qartë se ka nevojë për propozime të cilat ne, si komunë, do t'i përfshijmë në buxhet. Faleminderit edhe një herë të gjithë atyre që iu përgjigjën ftesës dhe morën pjesë.

Linqet e lajmeve për mbajtjen e dëgjimit buxhetor, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-degjimi-buxhetor-me-drejto-re-te-sbkollave-pedagoge-punetore-arsimore-dhe-punetore-shendetesore-per-kab-2027-2029/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzana-je-budzetsko-saslusanje-sa-direktorima-skola-pedagozima-prosvetnim-radnicima-i-zdravstvenim-radnicima-za-sbo-2027-2029/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1E9or2zHUK/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/14kYDw7Yzav/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 11.06.2026

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESE MARRËSVE NË DËGJIMIN BUXHETOR ME
DREJTORË TË SHKOLLAVE, PEDAGOGË, PUNËTORË ARSIMORË
DHE PUNËTORË SHËNDETËSORË PËR KAB 2027-2029

LISTA UÇESNIKA NA RASPRAVA BUDŽETA SA DIREKTORIMA
ŠKOLA, PEDAGOZIMA, PROSVETNIM RADNICIMA I ZDRAVSTVENIM
RADNICIMA ZA SBO 2027-2029

Nr. Br.	Emri dhe Mbiemri Ime i Prezime	Vendbanimi Prebivalište	Etnia Etnička pripadnost	M M	F Ž	Nënshkrimi Potpis
1	BEHAR SHALA	BREZNE	SHQIPTAR	✓		
2	AJPS MYRTEZANI	ZAPILLUNË	SHQIPTAR	✓		
3	Qumir Myrtetani	BAODOSANË	SHQIPTAR	✓		
4	Behar Guri	KOSAVË	SHQIPTAR	✓		
5	Visar Veseli	BRODOSIM	SHQIPTAR	✓		
6	VAJON SEFIDINI	BELUT	SHQIPTAR	✓		
7	Mehadin Çarçalaj	Kuencë	SHQIPTAR	✓		
8	SINAH ALIU	BLAQ	SHQIPTAR	✓		
9	Jasmir Joluzi	Krushenë	Bošnjak	✓		
10	SUAD TOSUNI	PAFET	Bošnjak	✓		
11	MEHMET SEJDIU	Dragas	Bošnjak	✓		
12	SAMO GORANCI	DRAGAS	GORANAC	✓		
13	RENAN SKENIĆ	RIČIĆ	BOŠNIJAK	✓		
14	SHARIR SKRIBI	PRONC	SHQIPTAR	✓		
15	FARI KOZLOVI	KOSAVË	Shqiptar	✓		
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

02 Nr. Br. 453/01-10176/26/2
M. o. G. 20 26
Dragash - Dragaš

